



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 nëntor 2016
Nr. Ref.:RK1005/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KIo5/16

Parashtrues

Gani Govori

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 222/2015, të 19 gushtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gani Govori nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), të cilin e përfaqëson Hamdi Podvorica, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 222/2015, të 19 gushtit 2015.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 1 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës në periudhën prej vitit 1984 deri në vitin 2000 ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: BVI) në pozitën arkivist.
11. Me vendosjen e Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut në Kosovë, në bazë të Rregullores 2000/10 është themeluar edhe Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Departamenti Administrativ) dhe pas kësaj, për nevojat e këtij Departamenti Administrativ është publikuar konkursi për vendet e caktuara të punës.

12. Parashtruesi i kërkesës ka konkurruar për një nga vendet e punës dhe pas seleksionimit të kryer më 7 nëntor 2000 është njoftuar se nuk është pranuar në vendin e punës në fjalë.
13. Më 3 mars 2001, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër procedurës së seleksionimit të punëtorëve në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Më 12 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë [me Aktgjykimin C1. nr. 71/2003], refuzoi ankesën e parashtruesit.
15. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [C1. nr. 71/2003] të Gjykatës Komunale në Prishtinë ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
16. Më 30 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [me Aktvendimin Ac. nr. 48/2008] miratoi ankesën e parashtruesit, prishi aktgjykimin e shkallës së parë [C1. nr. 71/2003] dhe e ktheu çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
17. Më 14 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, në riprocedurë [me Aktgjykimin C. nr. 2591/10] refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Komunale, ndër të tjera, theksoi:

"[...] Pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, të punësuarve dhe ish të punësuarve u është mundësuar të konkurrojnë në kushte të barabarta për vendet e punës që kanë mundur të jenë analoge me vendet e punës në institucionet e paraluftës, mirëpo në kuptimin formalë juridikë konkurrentët kanë qenë të barabartë siç përcakton edhe pika 6 e Udhëzimit Administrativ 02/2002 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale".

18. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [C. nr. 2591/10] të Gjykatës Komunale në Prishtinë ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
19. Më 29 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit [me Aktgjykimin Ac. nr. 4052/2012] refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 2591/10] të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
20. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 4052/2012] të Gjykatës së Apelit paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme.
21. Më 19 gusht 2015, Gjykata Supreme [me Aktgjykimin, Rev. nr. 222/2015] refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit dhe i vërtetoi në tërësi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Supreme, ndër të tjera, theksoi:

"Me krijimin e institucioneve të reja me Rregulloren nr. 2000/10 është themeluar Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë i cili nuk është trashëgimtar i asnjë institucioni të Kosovës nga periudha e

paraluftës. Kjo do të thotë se ky Departament nuk është suksesor i BVI për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Kosovës andaj nuk qëndron obligimi i të paditurës që paditësit t'ia vazhdojë marrëdhënien e punës. Pranimi i personelit të ri në institucionet e formuara është bërë me procedurën e konkursit në pajtim me rregullat juridike të aplikueshme tek shërbyesit civil të Kosovës në të cilin konkurs paditësi ka aplikuar por nuk është pranuar. Prandaj, çdo parashtrim në revizion lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale është i papranueshëm”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje të pronës, e të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe të së drejtës për mbrojtje shëndetësore dhe sociale.
23. Parashtruesi i kërkesës konsideron se arsyetimi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm.
24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vërtetojë se shkeljet e listuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë bërë në dëm të parashtruesit të kërkesës dhe të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 222/2015, të 19 gushtit 2015 dhe t'ia kthejë Aktgjykimin Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

28. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje të pronës, e të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe të së drejtës për mbrojtje shëndetësore dhe sociale.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja ka ndodhur për shkak të arsyetimit të pabazuar dhe të paqëndrueshëm në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe në aktgjykimet e gjykatave më të ulëta.
31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë asnjë arsyetim procedural ose material si mbështetje për ankesën e tij. Ai vetëm iu referohet neneve të Kushtetutës në lidhje me të drejtat e përmendura, pa ofruar ndonjë shpjegim të mëtijshëm se si dhe pse ka ndodhur shkelja e pretenduar kushtetuese.
32. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë se ai mund të ngrejë një kërkesë të suksesshme dhe të pranueshme, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij/saj të mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
33. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, si dhe të gjitha gjykatat e tjera të rregullta e kanë hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar, për shkak se Departamenti Administrativ nuk është suksesor i BVI-së, andaj nuk qëndron obligimi i Departamentit Administrativ që parashtruesit t’ia vazhdojë marrëdhënien e punës ose t’i jep përparësi në procesin e seleksionimit. Rrjedhimisht dhe në bazë të seleksionimit të zbatuar, parashtruesi i kërkesës nuk është pranuar në marrëdhënie pune.
34. Në fakt, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme, si dhe të gjitha gjykatat e tjera të rregullta kanë dhënë arsyetim të qartë dhe përfundime të sakta në bazë të gjendjes faktike e cila është vërtetuar në procedurën gjyqësore. Nga ana tjetër, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse i janë shkelur të drejtat e tij me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
35. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

36. Për më tepër, Gjykata konsideron se në procedurën e zbatuar nuk ka asgjë që tregon se procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se referimi në shkeljen e Kushtetutës është i pabazuar.
37. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi